

Astrit SAHITAJ

RRUGA NAISSUS-LISSUS

Për periudhën e antikitetit të hershëm nuk kemi paraqitje hartografike për trevat e paraardhësve tanë. Nga shekulli III para Krishtit përpilohen harta me shkallë të vogël zvogëlimi, por në to hasim në emra vendbanimesh e lumenjsh si: Lissus, Skodra, Drilon, Aous e tjerë. Njëra nga hartat më të pasura me toponime është harta romake Tabula Peutingeriana. Ajo na ndihmon për të pasur një vizion më të qartë për rrugën Lissus –Naissus.

Lissusi (Lezha) gjendet në një pozitë të mirë gjeografike. Ndodhet afër buzëdetit Adriatik ku është formuar Gjiri i Lezhës. Lissusi (në tekstin e më tejme: Lisi) ishte një vend kyç për zhvillimin ekonomik e kulturor, sepse mallrat hynin dhe dilnin nëpërmjet rrugëve detare dhe atyre tokësore.

Emri i qytetit Lis lakohet shpeshherë nga Polybi, Tit Livi, Straboni, Ptolemei, Stefan Byzanti dhe, madje, gjendet i shënuar edhe në “Tabula Peutingeriana”. Prej tyre dëshmohet se Lisi ishte qendër e rëndësishme ekonomike e kulturore si edhe vend strategjik për t’u mbrojtur gjatë mësymjeve të armiqve. Kështu, nga autorët antikë, mësojmë se Teuta u strehua në qytetin Lis. Po ashtu për shkak të pozitës strategjike “Filipi ëndërronte të shtinte në dorë Lisin...në Lis ishin grumbulluar forca të mëdha... Genti ndodhej në Lis”¹. Edhe Tit Livi na jep të dhëna lidhur me mbretin Gent që “ ndodhet në Lis... mblodhi të gjitha forcat (15.000 këmbësorë)...kundër qytetit Basania,

1 Polybi, *Historitë*, në :Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 61, 62, 67.

5 milje larg... Lisi me shumë anije tri sere lopatash”². Straboni pohon se “Dodona e Lisi ishin qendra e pellazgëve”³. Ptolemeu në veprën e tij “Geographia” Lisin e vendos në shkallën 45 gradë- 41gradë e 10.⁴ Stefan Byzanti në veprën e tij “ De Urbibus et populis” për qytetin Lis thotë: “Lissos qytet i Ilirisë dhe Akro Lissos (Lisi i Epërm) Emri etnik Lissios dhe Lisseus”⁵

Për rrugën Lissus -Naissus na ndihmon shumë “Tabula peuntigeriana” e cila krahas emrave toponimike shënon edhe distancat nga një qytet në tjetrin. Kështu në bazë të saj, përafërsisht, orientohemi si për pozitën gjeografike ashtu edhe për largësitë nga qyteti në qytet.

Duke u mbështetur në të dhënat e autorëve antikë mësojmë se Lisi jo vetëm që ishte qendër me rëndësi për gërshetimin e rrugëve tregtare, por edhe kishte ndikim edhe në jetën kulturore. Kështu monedhat e prera në Lis “...figurojnë edhe mbi tri monedhat e Ilirisë së Jugut”⁶. Edhe monedha labiane “është si ajo e prerë në Lis”⁷. Ngjashmëri jo e rastësishme.

Kjo dëshmon se Lisi në kohën antike ishte qendër e zhvilluar kulturore dhe ekonomike. Importi dhe eksporti bëhej me anë të lundrimit si në pjesën jugore ashtu edhe në atë veriore dhe me anë të rrugëve tokësore që lidhnin trasetë kryesore me rrjetin e degëzimeve të rrugëve dytësore të vendbanimeve, që gjendeshin në periferi të Lisit.

“Itineraret romake na japin pak shënime për rrugët dhe vendbanimet e këtij regjioni”⁸. Për të pasur një vizion më të qartë lypset të bazohemi në ato të dhëna që na jepen në shënimet e ndryshme, të cilat i gjejmë te autorët antikë ose te studiuesit që janë marrë me trajtimin e rrugëve antike. Nga autorët antikë mund të vjelim emra toponimike,

2 Tit Livi, *Nga themelimi i Romës*, në :Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 125, 138.

3 Straboni, *Gjeografia*, në :Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 160.

4 Ptolemeu, *Gjeografia*, në :Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 267.

5 Stefan Byzanti, *Mbi qytetet dhe popujt*, në :Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 149.

6 Hasan Ceka, *Në kërkim të historisë ilire*, Tiranë, 1998, f. 17.

7 Po aty, f. 177.

8 Dr. Emil Çerškov, *Romakët në Kosovë dhe municipiumi D.D te Soçanica*, Prishtinë 1973, f.43.

të cilët përmenden për arsye të ndryshme, për situata të veçanta si në aspektin e ballafaqimit me luftëra nga armiqtë si në aspektin ekonomik e kulturor.

Rruga Lissus-Naissus e cila përshkonte trevën verilindore të Shqipërisë me nisje nga Lisi (Lezha) duke vijuar buzë derdhjes së Drinit del në Rrafshin e Dukagjinit e të Kosovës dhe vijon kah Podujeva, Kurshumlia, afër Prokuplës e Brestovicës dhe lidhet me Nishin. Kjo hapësirë gjeografike e pasur me minerale si bakër, krom, hekur etj., ishte e një rëndësie të veçantë për popullatën e atyre anëve. Më poshtë po e paraqesim “Tabula Peutingeriana” – Miller IR., col. 525- 559 për të parë se si ka qenë pasqyruar grafiki itinerari i rrugës Lissus- Naissus:



Fig. 1. Tabula Peutingeriana

Siç shihet në “ Tabula Peutingeriana” janë shënuar stacionet rrugore të rrugës Lissus - Naissus dhe largësitë në mile me numra romak nga stacioni në stacion me këtë renditje: Lissus (Lezha) XXX - Ad Picaria (Puka) XXX – Creueni (Vau Spas mbi lumin Drin) XVII – Gabuleo (Pran Kusnenit) XXX – Theranda (Dule, afër Prizrenit) XXV-Vician (Ulpiana) XII – Veclanum (Pranë Prishtinës) XIX – Vinde- nis (Podujevë) XX - Ad Fines (Kurshumli) XX – Hammeo (Afër Proku- pljes) VI - Ad Herculem (Brestovica) XIV -Naisso.




Fig. 2. Rruga Lissus - Naissus

Në “Tabula Peutingeriana” Lezhën nga Puka e ndan largësia prej 30 mijesh romake, që do të thotë rreth 30 kilometra. Gjendet në veri të Lissus-it. Dihet se nga lumi Mat e deri në Pukë gjenden male dhe gryka malesh, me plot të përpjeta dhe me pak tatëpjeta. Po rreth e përqark Ad Pikaria-së ka pasur edhe vendbanime tjera që për nevojat e jetës së përditshme jetësore doemos u duhej të komunikonin mes veti. “Drejtimitet e shumë e shumë rrugëve, sidomos të atyre viciale, vareshin nga shpërndarja e atyre vendbanimeve mbi hapësirën nëpër të cilën kalonin.”⁹. Prandaj edhe ka shërbyer si qendër lidhëse e tyre me rrugën kryesore që shpinte për në Nish. Vet relievi malor i regjionit të Pukës përplot përrenjtë e male të thepisura, impononte përshtatjen e rrjetit rrugor të vendbanimeve periferike të Ad Pikarios.

Tridhjetë milje tregues në verilindje të Ad Pikaria- së si pas asaj tabele grafike, në rrugën Lis – Nish, gjendet stacioni Creueni. “Në bazë

9 Po aty, f. 42.

të gjetjeve arkeologjike të shekujve të pare të erës sonë, të gjetura në lagjen Gockë të Va Spasit”¹⁰ stacioni Creueni, i shënuar në itinerarin e njohur rrugor në tabelën romake, është identifikuar me Va- Spasin e sotëm. “Va Spasi është identifikuar me stacionin rrugor Creueni, të rrugës romake via Lissus- Naisus, të përmendur në itinerarin e njohur rrugor Tabula Peutingeriana. Në të mirë të rikonfirmimit të këtij burimi historik vijnë edhe disa gjetje arkeologjike të shekujve të para Krishtit të gjetura në lagjen Gockë të Va- Spasit, që ndodhet në një tarracë lumore në bregun e majtë të Drinit”¹¹. Kreueni kishte një pozitë kyçe. Pranë tij bashkohet lumi i Krumës me Drinin. Aty gërshetoheshin rrugët e kësaj zone të Drinit. Ky stacion ishte në një pozitë të mirë gjeografike, që mundësonte lidhjen me qendra të njohura qysh nga koha antike. Kështu si qendër e rëndësishme lidhëse mundësonte edhe lidhjen me qytetin Skodra dhe me kastrumin e Gegjës (Gjakovë). Po ashtu ishte edhe si qendër lidhëse edhe për vendbanimet e konglomeratave të afërme bri arteries rrugore Lissus- Naisus. Për kohën e atëhershme kishte rol dominues për çështje ekonomike. Prej Creuenit mund të bëheshin lidhje nëpërmjet vendbanimesh të periudhës romake si me Brutin, fortifikimin e Pecit dhe Bardhocit, të Morinit në drejtim të Therandës.

Për stacionin Gabuleo ka shumë mendime. Si pas Tabula Peutingeriana largësia ndërmyjet Creuenit dhe Gabuleo-s është 7 milje romake, ndërsa nga Theranda e ndajnë këtë stacion 30 milje romake. Studiuesit ndajnë mendimin se ky stacion duhet kërkuar aty ku bashkohet Drini i Bardhë dhe Drini i Zi. Pikërisht ajo pozitë i përgjigjet edhe largësisë së shënuar në milje treguesin e itinerarit romak. Këtë mendim e ushqejnë edhe të dhënat gjuhësore të publikuara nga Majer-i. Etimologjia e emrit Gabuleo me emrin Kukës nuk përputhet fare. Po te fundja kjo nuk e hedh poshtë idenë se Kukësi mund të identifikohet me Gabuleo-n, sepse njohim shumë fakte kur stacionet e ndryshme nuk i ruajtën emrat e tyre. Sidoqoftë Gabuleo është një stacion, që akoma nuk është identifikuar, por në të ardhmen mund të pasurohemi me gjetje arkeologjike që do ndihmojnë për identifikimin e saktë të këtij stacioni.

10 Komata, & A. Koka, *Të dhëna nga lugina e mesme e Drinit*, në: Iliria, Tiranë 1976/ VI, VI, f. 110.

11 L. Përzhita, G. Hoxha, *Fortifikime të shekujve IV-VI në Dardaninë Perëndimore*, Tiranë 2003, f. 30.

Theranda është njëri nga stacionet që u ka sjell kokëçarje të mëdha historianëve për çështjen e përcaktimit të hapësirës së shtrirjes. Rreth kësaj çështjeje ka mendime të ndryshme, që janë dhënë nga arkeologë e gjuhëtarë të shquar. Po përkundër këtij mudi të madh edhe sot e kësaj dite kjo çështje mbetet problem për t'u zgjidhur. Përcaktimi i vendit se ku ishte ngulitur ky stacion- është paksa i ndërlikuar për faktin se studiuesit akoma nuk janë përcaktuar definitivisht për arterien rrugore Lissus – Naisus. Ca nga studiuesit mendojnë se traseja Lissus- Naissus do ketë qenë “Nashec- Piranë- Rahovec- Carallugë”¹². Ca të tjerë si rrugë të mundshme duhet kërkuar andej kah Dula. Për të qenë përcaktim i saktë duhet të dëshmohet me mbetje arkeologjike që do të dëshmonin për vend ekzistimin e tij. Ka mendime se traseja Lissus – Naissus mund të ketë kaluar nëpër “magjistralen Kosovë – Shkodër. Kjo, si edhe të tëra rrugët e mëvonshme, ishte e detyruar të përdorë lugun Dule”¹³. Kjo grykë nga krahu i majtë dhe i djathtë rrethohet nga malet e veshura, por bukur të thepisura. Pra për të shkuar nga Dula në Rrafshin e Kosovës patjetër duhet të shkohet grykës së Ceralevës. Po të kihet parasysh distanca e shënuar në Tabula Peutingeriana, Therandën nga Gabuleo e ndajnë XXX milje romake, për afërsisht 45 kilometra; ndërsa nga Viciano (Lipjani) XXV milje romake, për afërsisht 38 kilometra. Kështu kjo largësi përafron mundësinë e përcaktimit të Therandës se ajo duhet kërkuar diku nëpër regjionin e Suharekës së sotme. Këtë mendim e ndan edhe E. Çernishkovi¹⁴. Ai vë në dukje se kjo, për të identifikuar se në ç’vend ka qenë i vendosur ky qytet, varet vetëm nëse dëshmohet me anën e mbetjeve arkeologjike të këtij qyteti, të cilat mund të hasen në të ardhshmen. Po ashtu ai mendon se vendbanimet Nashec, Piranë e Tërnye tregojnë drejtimin e mëtejshëm të kësaj rruge.

Tomascheku mendon për një drejtim tjetër rrugor të asaj kohe. Ai mendon se ajo rrugë ka shkuar në drejtimin e rrugës bashkëkohore, “Rahovec- Prishtinë. Kështu sipas tij Therandën duhet kërkuar në rrethinën e fshatit Carallugë (e Malishevës)”¹⁵. Për të ardhur deri këtu ai ndjek trasenë rrugore nga Gabuleo - Dobrugj – Lumi Mirushë – Lubi-

12 Emil Çerashkov, *Romakët në Kosovë...*, f. 46.

13 Po aty, f. 45.

14 Po aty, f. 46.

15 Po aty, f. 47.

zhdë. Po këto janë vetëm hipoteza. Prapëseprapë është më i logjikshëm supozimi se nga Theranda rruga ka vijuar nëpër grykën e Caralevës, sepse kjo grykë kalohet me më pak vështirësi. Përpjetat nuk janë aq të thikta sa të mos kalohen.

Nga Theranda shkohet për në Viciano – (mendohet të jetë afër Lipjanit të sotëm).

Çershkovi në veprën e tij Naissus – Scupi tregon se në fshatin Uglar janë gjetur “mbeturinat e stacionit Vicianum”¹⁶. Po si duket këto gjetje arkeologjike nuk janë të mjaftueshme për t’u përcaktuar më saktësi ubifikimi i tij, sepse lidhur me të janë dhënë edhe shumë hipoteza nga studiues të ndryshëm. Disa nga gjurmuesit mendojnë se Vicianumi duhet kërkuar në rrethinat e Ulpianës; disa të tjerë thonë se Vicianumi duhet kërkuar në rrethinat e Prishtinës aty kah Çagllavica. Deri më sot akoma nuk është përcaktuar saktësisht vendndodhja e këtij stacioni. Një gjë dihet se ky stacion ishte qendër e rëndësishme në arterien e rrugës Lissus – Naissus. Në bazë të gjetjeve të ardhshme arkeologjike do përcaktohet edhe vendi i këtij stacioni.

Edhe stacioni i shënuar në miljetreguesin me emrin Veclanum mendohet të jetë diku në rrethinat e Prishtinës. Edhe për këtë stacion duhet pritur rezultatet e gjetjeve arkeologjike që mund të ndodhin në të ardhmen.

Një stacion tjetër me rëndësi është edhe ai i Vindenisit. Ky stacion është shënuar nga Ptolemeu dhe gjendet në Tabula Peutingeriana. Gjurmët e këtij stacioni u zbuluan në fshatin Gllavnik. Ky fshat gjendet 5 kilometra në jugperëndim të Podujevës. Prandaj bazuar në këto gjetje, shumë studiues mendojnë se Vindesi romak duhet të kërkohet në qytetin e Podujevës. Ky vendbanim ka qenë vend kyç për vendbanimet e atij regjioni.

Nga stacioni Vindenisi traseja shkonte “duke shkuar nëpër luginën e lumit Llap e duke kaluar Prepolcin e sotëm dhe ultësirën e lumit Banjë, arrihet në Kurshumli”¹⁷, që mendohet t’i përgjigjet, qytetit romak Ad Fines. Si duket edhe ky stacion ka luajtur një rol të rëndësishme si nyje lidhëse për vendbanimet viciale të asaj rrethine.

Ky stacion gjendej në skaj të Kosovës. Në drejtim të Nishit nga

16 Po aty, f. 44.

17 Dr. Gavro Shkrivaniq, *Putevi u srednjojevkovnoj Srbiji*, Beograd, 1974, f. 88.

stacioni Ad Fines shkohet në stacionin Hammeo. Bazuar në miletreguesin e Myller-it ky stacion është shënuar të jetë afër Prokupjes. Nga Hammeo shkohet në Ad Herculem, që është Brestovica e sotme. Nga Ad Herculemi deri në Naissus largësia, sipas miljetreguesit është XIV. Naissus-i ishte nyje lidhëse

Për t'u identifikuar rruga kryesore që nga Lissus-i e deri te Naissus-i nuk është aspak e lehtë, sepse shumica e rrugëve janë shkatërruar nga erozionet e shkaktuara nga faktorë të jashtëm si: gërryerjet e shkaktuara nga ujërat e të reshurave atmosferike, nga vërshimet e përrrenjve e të lumenjve, nga shkarjet e akullnajave dhe ortekëve dhe nga erërat e fuqishme. Po ashtu në shkatërrimin dhe fshirjen e rrugëve ka ndikuar edhe terreni i zonave kah kanë kaluar rrugët. Rrugët e zonave fushore janë shkatërruar dhe madje janë tjetërsuar për shkak se ato ishin bërë nëpër vende të rrafshëta, të cilat pas reshjeve atmosferike mbuloheshin nga balta. Këto rrugë, nëse janë braktisur nga shfrytëzimi e kanë pësuar edhe për shkak se janë punuar për sigurimin e ekzistencës jetësore të banorëve vendas.

Edhe pse janë bërë përpjekje të shumta për të përcaktuar rrugët dhe vendbanimet sipas itinerareve romake dhe sipas shkrimeve të hershme gjeografike, prapëseprapë ka mbetur edhe shumë punë për t'u bërë për t'i ndriçuar saktësisht ato.

Astrit SAHITAJ

SUMMARY

NAISSUS-LISSUS ROAD

First maps of small scale minimization were developed by the third century B.C. which included dwelling and river names, helping us create a clear picture in determination of geographical nominations. Likewise, Tabula Peutingeriana is a very helpful map in locating directions of Lissus – Naissus road as well as representation of its station locations. Except for dwellings data, this map includes distances between them. Also, writings of antique authors provide valuable source in identifying dwelling names and their role in diverse aspects of human life.

According to Tabula Peutingeriana can be concluded that Lissus – Naissus road starting from Lisi going through north-eastern parts of Albania, continuing through river Drin valley leading to Kosova and Dugagjini plains further in direction of Podujeva to Kurshumlia nearby Prokuple and Brestovica connecting to Nish (Naissus).

Though Tabula Peutingeriana includes distances between dwellings, until present day have not been precisely determined locations of mentioned towns, either by maps or antique authors. Therefore, accurate identification of following towns – Theranda, Viciano and Veclanum remains questionable till present, waiting for archeological findings and excavations.

